**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER ERMAL XH. HAMZAJ**
**ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia Bashkiake Nr. 5**
**TEL: 698227426**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 5706** **Nr. koleksioni: 3864**

**Tirane më 03/10/2023**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2023053150400672565

*Akti noterial përbëhet nga 7 fletë

A2023053150400672565

# KONTRATE
# SHITJE KUOTASH
# ME KUSHT

Në Tiranë, sot në datën 03/10/2023 (dymijë e njezet e tre), përpara meje Ermal Xh. Hamzaj, Noter, Anetar i Dhomës se Noterëve Tiranë, me liçense profesionale nr.511, në studion time noteriale me adresë Rr: "Pashko Vasa", Pall.8, Njësia Bashkiake Nr.5, u paraqitën personalisht palët me identitete si më poshtë:

**1- Shoqeria "Zurich Investment GROUP" SHPK**, shoqeri tregtare e se drejtes Shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar te QKB me date 25.06.2021, me NIPT/NUIS M11825004M, me zyre qendrore ne adresen Tirane, Rruga e Kosovareve, Pallati Dolçka, Apartamenti ½, Njesia Adminstrative nr.5 Tirane, perfaqesuar ne kete akt noterial nga Ortaku i vetem dhe administratori i saj **Z.Alban EFTHIMI**, atesia Romeo, i datelindjes 13.10.1970, lindur dhe banues ne Tirane, Njesia Administrative nr.5, shtetes Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. personal H01013093A;

**2-Z.Altin PREMTI**, atesia Veli, i datelindjes 30.08.1971, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Njesia Administrative nr.8, shtetes Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, i martuar me Znj.Daniela NIKA, mbajtes i leternjoftimit nr. personal H10830113G *perfaqesuar ne kete kontrate shitje kuotash nepermjet Prokures se Posacme Nr.4621 Rep, Nr.1192 Kol, Tirane me 22.09.2023 Noter Stela R.Demneri, Tirane* nga **Z. Alban Efthimi**, atesia Romeo, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues ne Tirane, Njesia Administrative Nr.5, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit ID nr.036022174 dhe nr personal H01013093A.

**3-Z.Olsi EFTHIMI**, atesia Romeo, i datelindjes 04.01.1978, lindur dhe banues ne Tirane, Njesia Administrative nr.10, shtetes Shqiptar, i martuar me Znj.Enila CENKO, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. personal H80104094S.

**4-Z.Andi EFTHIMI**, atesia Romeo, i datelindjes 04.01.1978, lindur dhe banues ne Tirane, Njesia Administrative nr.10, shtetes Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, i martuar me Znj.Eneida EFTHIMI, mbajtes i leternjoftimit nr. personal H80104093K**; te gjithe referuar me poshte si "Shitesit";**

dhe

**1- Znj. Daniela NIKA**, atesia Gjok, e datelindjes 18.02.1972, lindur ne Lezhe dhe banuese ne Tirane, Njësia Administrative Nr. 8, shtetase Shqiptare, e martauar me Z. Altin PREMTI, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e Leternjoftimit me Nr. Personal H25218060T, e cila jep pëlqimin me shkrim për këtë shitje sipas kushteve te percaktuara në këtë kontratë, *perfaqesuar ne kete kontrate shitje kuotash nepermjet Prokures se Posacme Nr.4621 Rep, Nr.1192 Kol, Tirane me 22.09.2023 Noter Stela R.Demneri, Tirane* nga **Z. Alban Efthimi**, atesia Romeo, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues ne Tirane, Njesia Administrative Nr.5, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit ID nr.036022174 dhe nr personal H01013093A.

**2- Znj. Enila CENKO**, atesia Edmond, e datelindjes 19.02.1980, lindur dhe banuese ne Tirane, Njësia Administrative Nr. 10, shtetase Shqiptare, e martauar me Z. Olsi EFTHIMI, madhore, me

A202305315040067256

zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e Leternjoftimit me Nr. Personal I05219125U, e cila jep pëlqimin me shkrim për këtë shitje sipas kushteve te percaktuara në këtë kontratë.
**3- Znj. Eneida EFTHIMI**, atesia Harallamb, e datelindjes 30.04.1986, lindur dhe banuese ne Tirane, Njësia Administrative Nr. 10, shtetase Shqiptare, e martauar me Z. Andi EFTHIMI, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e Leternjoftimit me Nr. Personal I65430072V, e cila jep pëlqimin me shkrim për këtë shitje sipas kushteve te percaktuara në këtë kontratë.**te gjithe referuar me poshte si "DHENESIT TE PELQIMIT";**

dhe

**Z.Ylli GJONI**, atesia Vexhi, i datelindjes 09.11.1973, lindur dhe banues në Tirane, Njesia Administrative nr.5, shtetas Shqiptar, madhor, me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr.personal H31109057Q **referuar me poshte si "Bleresi".**

**MEQENESE ekzistojne faktet:**

-**Shoqeria "Zurich Investment GROUP" SHPK** *eshte ortake e shoqerise* ***"SEED CONSULTING" SHPK****, shoqeri tregtare e se drejtes Shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar te QKR me date 24.06.2014, me NIPT/NUIS L418240014Q, me zyre qendrore ne adresen Tirane, Rruga e Kosovareve Ndertesa 35, h.6, ap.2, Njesia Administrative nr.5, 1019, dhe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise.*
- **Z.Altin PREMTI** *eshte ortak i shoqerise* ***"SEED CONSULTING" SHPK****, shoqeri tregtare e se drejtes Shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar te QKR me date 24.06.2014, me NIPT/NUIS L418240014Q, me zyre qendrore ne adresen Tirane, Rruga e Kosovareve Ndertesa 35, h.6, ap.2, Njesia Administrative nr.5, 1019, dhe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise.*
- **Z.Olsi EFTHIMI** *eshte ortak i shoqerise* ***"SEED CONSULTING" SHPK****, shoqeri tregtare e se drejtes Shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar te QKR me date 24.06.2014, me NIPT/NUIS L418240014Q, me zyre qendrore ne adresen Tirane, Rruga e Kosovareve Ndertesa 35, h.6, ap.2, Njesia Administrative nr.5, 1019, dhe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise.*
- **Z.Andi EFTHIMI** *eshte ortak i shoqerise* ***"SEED CONSULTING" SHPK****, shoqeri tregtare e se drejtes Shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar te QKR me date 24.06.2014, me NIPT/NUIS L418240014Q, me zyre qendrore ne adresen Tirane, Rruga e Kosovareve Ndertesa 35, h.6, ap.2, Njesia Administrative nr.5, 1019, dhe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise.*

*Te gjithe shitesit e mesiperm ne menyre individuale deklarojne se deshirojne te shesin teresisht kuotat qe ata zoterojne ne shoqeri, ortakut ekzistues* **Z.Ylli GJONI***, sipas Vendimit nr.3 date 25/09/2023 te Asamblese te Ortakeve te shoqerise* ***"SEED CONSULTING" SHPK, bashkelidhur kesaj kontrate****.*

**Z.Ylli GJONI**,, *deklaron se deshiron ti bleje te gjithe shitesve te mesiperm teresisht te gjitha kuotat e zoteruara prej tyre ne shoqeri, sipas kushteve te meposhtme.*

*Palet e mesiperme me vullnet te lire dhe te plote, me kerkuan mua noterit hartimin e kesaj kontrate shitje kuotash me kusht, me permbajtjen si me poshte :*

A2023053150400672565

*Përkufizime*

1-"**Atelier 4**" ka kuptimin e shoqërisë "ATELIER 4" SHPK, subjekt tregtar i te drejtes Shqiptare, me seli ne Tirane, Rruga e Kosovareve, Ndertesa 32,H.6, Ap.4/1,Njesia Administrative Nr.5, 1019, regjistruar person juridik date 01.05.2003, me numer Unik te Identifikimit te Subjektit K31812012H.

2-"**Pasuritë e Paluajtshme**" ka kuptimin e:

(a) Njesisë N15, e ndodhur ne Rruga "Sami Frasheri" Tirane, me sipërfaqe neto 73.20 m2, me numër pasurie 7/298-N15, Zona kadastrale 8270, Volumi 86, faqe 229, Zyra nr.1, kati 1, vertetuar sipas Çertifikates per Vertetim Pronesie me Nr. 1452170 te leshuar nga ASHK Tirane me date 06.02.2017;

(b) Njesi N16, e ndodhur ne Rruga "Sami Frasheri" Tirane, me sipërfaqe neto 46.40 m2, me numër pasurie 7/298-N16, Zona kadastrale 8270, Volumi 86, faqe 230, vertetuar sipas Çertifikates per Vertetim Pronesie me Nr. 1452168 te leshuar nga ASHK Tirane me date 06.02.2017.

3- "**Seed Consulting**" ka kuptimin e shoqërisë "SEED CONSULTING" SHPK, subjekt tregtar i te drejtes Shqiptare, me seli ne Tirane, Rruga e Kosovareve, Ndertesa 32,H.6,Ap.2, Njesia Administrative Nr.5, 1019, regjistruar person juridik date 24.06.2014, me numer Unik te Identifikimit te Subjektit L41824014Q.

***Neni 1***

***Qellimi i kontrates***

-Qellimi i kesaj kontrate eshte transferimi individual i pronesise te kuotave nga shitesit tek bleresi.

-Kjo kontrate sherben per percaktimin e kritereve, procedurave dhe menyres se tranferimit te pronesise dhe pageses perkatese lidhur me kete transferim.

-Ne percaktim te kushteve, palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

***Neni 2***

***Objekti i kontrates***

-Nepermjet kesaj kontrate, pas përmbushjes së kushtit në përputhje me Nenin 5 *(Kushti)*, shitesit transferojne ne favor te bleresit teresisht te gjitha kuotat e zoteruara prej tyre ne shoqeri, te cilat perfaqesojne ne total 50 % te kapitalit te shoqerise, ne baze te çmimit te percaktuar ne nenin 3 me poshte.

-Gjithashtu, bleresi do te bleje nga shitesit teresisht te gjitha kuotat e zoteruara prej tyre ne shoqeri, te cilat perfaqesojne 50 % te kapitalit te shoqerise, ne baze te çmimit te percaktuar ne nenin 3 me poshte dhe për pasojë do të marrë pronësinë e këtyre kuotave pas përmbushjes së kushtit sipas Nenit 5 *(Kushti)*.

***Neni 3***

***Çmimi dhe menyra e pagimit***

**1.**Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre qe cmimi i shitjes te seiciles kuote qe shitesit transferojne ne menyre individuale ne favor te bleresit do te jete:

**a) Shoqeria "Zurich Investment GROUP" SHPK shet 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise kundrejt cmimit EUR 100.000 (njeqind mije euro);**

**b) Z.Altin PREMTI shet 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise kundrejt cmimit EUR 100.000 (njeqind mije euro);**

**c) Z.Olsi EFTHIMI shet 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise kundrejt cmimit EUR 100.000 (njeqind mije euro);**
**d) Z.Andi EFTHIMI shet 1 kuote qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise kundrejt cmimit EUR 100.000 (njeqind mije euro);**
2.Pagesa e cmimit te blerjes se kuotave per seicilin shites do te paguhet nga bleresi brenda 3(tre) diteve nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate, me veprime bankare ne llogarine individuale bankare te seiciles pale shitese, bashkelidhur kesaj kontrate.Mandati bankar perben prove te plote te likujdimit te cmimit nga ana e pales blerese.
3. Në përputhje me nenin 84 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, palet vene si kusht që, nëse pala blerëse nuk i paguan seiciles palës shitëse teresisht çmimin e blerjes brenda afatit kohor te percaktuar me siper, kjo Kontratë Shitje do të konsiderohet automatikisht e zgjidhur dhe palët kthehen në gjëndjen e mëparshme.

***Neni 4***
***Pergjegjesite dhe garanci te paleve***

Secili prej Shitesve nepermjet kesaj kontrate per shitje kuotash garanton bleresit si me poshte:

a) se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotes individuale qe po trasferohet me kete kontrate shitje;
b) se kontributi monetar i derdhur prej tij per zoterimin e kuotes individuale, objekt te kesaj kontrate shitje ben pjese ne pasurite vetjake ne referim te nenin 77 te Kodit te Familjes ne fuqi. Ne rast pretendimi te familjareve te shitesve per detyrim financiar, te gjitha demet financiare do te perballohen me mjete financiare personale te vet shitesve ne menyre individuale, duke bere qe bleresi dhe shoqeria "SEED CONSULTING" SHPK te jene te perjashtuar nga çdo lloj pergjegjesie civile apo penale ne ngarkim te tyre.
c) se kuota objekt shitje eshte plotesisht e lire nga cdo barre, detyrim, te drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjeter.
d) se shoqeria nuk ka detyrime financiare te pashlyera apo aq me teper te padeklaruara ndaj institucioneve shteterore apo personave te trete fizik apo juridik, me perjashtim te atyre, te cilat jane te pasqyruara ne kontabilitet te shoqerise dhe qe i jane bere te dituara pales blerese perpara nenshkrimit te kesaj kontrate.
e) Shitesit deklarojne se pasi te arketojne cmimin e shitjes do te paguajne seicili ne menyre individuale prane Zyres te Tatim Taksave apo cdo organi tatimor, tatimin mbi te ardhurat qe kane perfituar nga kjo shitje. Ne rast mospagese te ketij detyrimi, bleresi dhe shoqeria "SEED CONSULTING" SHPK jane te perjashtuar nga çdo lloj pergjegjesie civile apo penale ne ngarkim te tyre per shkak se sipas ligjit nuk jane pergjegjes per te deklaruar apo paguar kete tatim dhe shitesit do te jene pergjegjes te vetem individualisht per te gjitha pasojat ligjore civile apo penale. Te gjitha demet financiare qe mund te gjenerohen nga mospagimi i ketij tatimit, do te perballohen me mjete financiare personale te vet shitesve ne menyre individuale.
f) Pas nenshkrimit te kesaj kontrate te shitjes te kuotave dhe pas pageses te cmimit te shitjes nga bleresi, cdo ish-ortak sa me siper nuk do te vijoje te jete me ortak i shoqerise dhe ortaket shites apo cdo person i lidhur me te, heq dore ne menyre te parevokueshme nga cdo funksion drejtues qe kryente ne Shoqerine "SEED Consulting" sh.p.k si dhe nga cdo pretendim tjeter financiar ndaj shoqerise.

**NENI 5**
***Kushti***

A2023053150400672565

*1*-*Në* përputhje me nenin 84 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, palët bien dakord që pronësia e kuotave do të kalojë vetëm pas plotësimit të dy ngjarjeve si më poshtë:

(a) pala blerëse i paguan palës shitëse tërësisht çmimin e blerjes brenda afatit kohor te percaktuar në Nenin 3 *(Çmimi dhe mënyra e pagimit)* të kësaj kontrate; si dhe

(b) është realizuar me sukses kalimi i pronësisë së Pasurive të Paluajtshme në përputhje me kontratën përkatëse të shitjes, në përputhje të plotë me paragrafin 2 të këtij neni, fakt i cili do te konfirmohet me vertetim noterial te leshuar nga noteri Ermal XH.HAMZAJ.

2-Mes **"SEED CONSULTING"** në rolin e shitësit dhe **"ATELIER 4"** në rolin e blerësit është nënshkruar një kontratë shitjeje për kalimin e pronësisë së Pasurive të Paluajtshme.

3-Ne rast perfundimi me sukses te kontrates te shitjes te Pasurive të Paluajtshme sa me lart permendur brenda afateve kohore te percaktuar ne kontrate, noteri Ermal Xh.HAMZAJ do te leshoje vertetimin noterial qe konfirmon perfundimin me sukses te kesaj shitblerje si dhe plotesimin e kushtit sipas kesaj kontrate shitje te kuotave me kusht. Nje kopje ekzemplari do te depozitohet bashke me kete kontrate shitje kuotash ne QKB per te kaluar pronesine e lire dhe pa kufizime ne favor te pales blerese.

### *NENI 6*
### *Efektet e kontrates*

-Kjo kontrate ka fuqine e ligjit per palet nga momenti i nenshkrimit te saj perpara noterit dhe mund te ndryshohet vetem me marreveshje me shkrim dypaleshe.

-Kontrata ka efekt per palet e treta ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Per me shume qartesi, palet deklarojne qe detyrimet e shitesit sa me siper, jane solidale ndermjet tyre.

### *NENI 7*
### *Informacioni konfidencial*

-Palet detyrohen te mbajne konfidencial te gjithe dokumentacionin, te dhenat dhe cdo informacion te perfituar gjate marrdhenies se tyre ne shoqeri apo dhe referuar marredhenies konkrete te krijuar me kete kontrate.

### *NENI 8*
### *Transferimi i te drejtave*

Veten pasi pala blerese te kete paguar teresisht cmimin e blerjes ne llogari te pales shitese sipas mandateve bankare bashkelidhur kesaj kontrate si dhe pas plotesimit te kushtit sipas nenit 5, pika 2 me siper te konfirmuar nga noteri Ermal Xh.HAMZAJ Tirane, kontrata do te depozitohet dhe regjistrohet nga bleresi prane regjistrit tregtar te QKB per kalimin e lire dhe pa kufizime te pronesise te te gjitha kuotave ne emer te bleresit dhe *kapitali i shoqerise do te zoterohet 100% nga ortaku ekzistues* **Z.Ylli GJONI**

### *NENI 9*
### *Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente*

-Kontrata eshte hartuar ne perputhje me Legjislacionin tregtar ne fuqi.

-Bleresi dhe shitesi angazhohen te bejne cdo perpjekje per zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konfliktet te mundshme qe mund te krijohen midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negocimeve te drejteperdrejta.

-Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konflikteve midis tyre, ceshtja do ti nenshtrohet juridiksionit gjyqesor.

A2023053150400672565

## *NENI 10*

## *Dispozita perfundimtare*

-Kjo kontrate eshte hartuar ne 6 (gjashte) kopje, ne gjuhen Shqip, ne 5 (pese) faqe, me vlere te njejte ligjore nga nje per seicilen pale, e cila ju lexua me ze te larte e te qarte paleve nga une noteri ne gjuhen Shqip.
-Palet deklaruan se e degjuan, e kuptuan dhe meqenese kontrata eshte hartuar ne perputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nenshkruan personalisht dhe pa verejtje perpara meje noterit.
-Pas nenshkrimit te paleve, une noteri e nenshkrova dhe e vertetova kontraten sipas kerkesave te ligjit "Per Noterine" (i ndryshuar).

Gjithashtu palët autorizojnë mua noterin për përdorimin e të dhënave personale të tyre të bëra të ditura sa më sipër dhe se të dhënat e përdorura nga unë noteri në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e redaktimit të këtij akti. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 – i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

**PALET KONTRAKTORE**

**SHITESIT**

**1- Shoqeria "Zurich Investment GROUP" SHPK**

**Perfaqesuar nga: Z.Alban EFTHIMI**

Alban Efthimi

**2-Z.Altin PREMTI**

*Perfaqesuar me prokure nga:*

Alban Efthimi

**3-Z.Olsi EFTHIMI**

OLSI EFTHIMI

**4-Z.Andi EFTHIMI**

Andi Efthimi

**BLERESI**

**Z.Ylli GJONI**

Ylli Gjoni

**DHENES PELQIMI**

**1- Znj. Daniela NIKA**

*Perfaqesuar me prokure nga:*

Alban Efthimi

**2- Znj. Enila CENKO**

Enila Cenko

**3- Znj. Eneida EFTHIMI**

Eneida Efthimi

**NOTERI**
**Ermal Xh.HAMZAJ**

NOTER
ERMAL XH.HAMZAJ

NUIS : L41824014Q
Adresa : Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "E Kosovarëve" , Ndërtesa.35, H.6, Ap.2, 1019,Tiranë;

## V E N D I M Nr. 3

### I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE SEED CONSULTING DT 25.09.2023

Sot më datë 25.09.2023 në selinë e subjektit "**SEED Consulting " Sh.p.k**, u mblodh Asambleja e Ortakëve të kësaj shoqërie me pjesëmarrjen 100 % të zotëruesve të kuotave të kapitalit të shoqërisë si më poshtë :

1. **Ylli Gjoni, zotërues i 1(një) kuote, që përbënë 50.0 % të kapitalit**
2. **Zurich Investment Group , zotërues i 1(një) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit, perfaqesuar nga z. Alban Efthimi, administrator i shoqerise;**
3. **Altin Premti , zotërues i 1(një) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit**
4. **Andi Efthimi , zotërues i 1(një) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit**
5. **Olsi Efthimi , zotërues i 1(një) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit**

**Asambleja ka për rend dite :**

-Miratimin e shitjes se 50% te kapitalit te shoqerise, te perbere nga 4 (kater) kuota qe perfaqesojne individualisht nga 12.5% te kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k. te bleresi **Z. Ylli Gjoni**, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise.

-Miratimi i shkarkimit nga cdo detyre ekzekutive te ortakeve shites apo te cdo personi te lidhur me ta, menjehere pas shitjes se kuotes.

**Meqenese**

Sipas nenit 8 te statutit, kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.
Sipas nenit 13 te statutit, administratoret emerohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve.

**Atehere**

Ortaket e Shoqerise, zoterues te 100% te kuotave te kapitalit, pasi shqyrtuan ceshtjet e rendit te dites , konstatuan se shit-blerja e kuotave do te kryhet ndermjet ortakeve te shoqerise dhe ne perfundim te mbledhjes,

## V E N D O S E N:

I. Miratimin e shitjes se 50% te kapitalit te shoqerise, te perbere nga 4 (kater) kuota qe perfaqesojne individualisht nga 12.5% te kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k. te bleresi Z. Ylli Gjoni, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise, si vijon:

**a.**Miratimin e shitjes se 1 (nje) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k., ne pronesi te shoqerise **Zurich Investment Group,** me cmim 100,000 (njeqind mije) Euro, te bleresi **Z. Ylli Gjoni**, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise;
**b.**Miratimin e shitjes se 1 (nje) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k., ne pronesi te z.**Altin Premti,** me cmim 100,000 (njeqind mije) Euro, te bleresi Z. Ylli Gjoni, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise;

**c.**Miratimin e shitjes se 1 (nje) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k., ne pronesi te z.**Andi Efthimi,** me cmim 100,000 (njeqind mije) Euro, te bleresi Z. Ylli Gjoni, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise;

**d.**Miratimin e shitjes se 1 (nje) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k., ne pronesi te **z.Olsi Efthimi,** me cmim 100,000 (njeqind mije) Euro, te bleresi **Z. Ylli Gjoni**, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise;

Kushtet e shitjes do te percaktohen ne kontratat individuale te shitjes se kuotes.

**II.** Pronesia e kapitalit kalon ne daten e nenshkrimit te kontratave per shitjen e kuotave.

**III.** Pas nenshkrimit te kontratave te shitjes se kuotes dhe pageses se cmimit te shitjes, cdo ish-ortak nuk do te vijoje te jete ortak i shoqerise dhe ortaku shites apo cdo person i lidhur me te, heq dore nga cdo funksion drejtues qe kryente ne Shoqerine "SEED Consulting" sh.p.k..

**IV.**Depozitimin e këtij vendimi te kontratave se shit-blerjes se kuotes në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe në Regjistrin e Provareve Perfitues. Shoqeria "SEED Consulting" sh.p.k. do te zoterohet 100% nga ortaku i vetem Z. Ylli Gjoni.

**V.**Te ngarkohet administratori z. **Ylli Gjoni**, per kryerjen e te gjitha veprimeve te nevojshme per zbatimin e vendimeve te mesiperme.

Vendimi të përpilohet në 7 kopje të barazvlefshme dhe të nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

**Asambleja e Ortakeve**

**Zurich Investment Group sh.p.k.**
**Alban Efthimi**
**Administrator**

**Ylli Gjoni**

**Altin Premti**

**Andi Efthimi**

**Olsi Efthimi**

ANDI EFTHIMI

OLSI EFTHIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER STELA R. DEMNERI
ADRESA NR.5, GJIK KUQALI,
PALL"FERAR", NR.1, NR.13
TEL: 692437001

# PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 4621 Nr. koleksioni: 1192

Tirane më 22/09/2023

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

A2023051380130937038

A202305138013093703S

b.Miratimin e shitjes se 1 (nje) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k., ne pronesi te z.Altin Premti, me cmim 100,000 (njeqind mije) Euro, te bleresi Z. Ylli Gjoni, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise;
c.Miratimin e shitjes se 1 (nje) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k., ne pronesi te z.Andi Efthimi, me cmim 100,000 (njeqind mije) Euro, te bleresi Z. Ylli Gjoni, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise;
d.Miratimin e shitjes se 1 (nje) kuote, që përbënë 12.5 % të kapitalit te Shoqerise "SEED Consulting" sh.p.k., ne pronesi te z.Olsi Efthimi, me cmim 100,000 (njeqind mije) Euro, te bleresi Z. Ylli Gjoni, ortak, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise;
Nëpërmjet kësaj prokure të posaçme i japim të drejtë përfaqësuesit tonë, të nënshkruajë kontratën e shitjes së 1 (një) kuote në pronësinë e Z.Altin Premti, qe perfaqeson 12.5% te kapitalit te shoqerise "SEED CONSULTING", kundrejt cmimit EUR **100.000 (njeqind mije euro)**. Fondet nga shitja e kuotave do te kalojne ne llogarinë e Z.Altin Premti me të dhënat:
**ALTIN PREMTI**
**IBAN EUR: AL81205115574057 24CLIDCFEURE**
**Numer llogarie: 505405724**
**BANKA KOMBETARE TREGTARE**
**BIC/Swift code: NCBAALTX**

- Kushtet e shitjes do te percaktohen ne kontratën e shitjes së kuotes në të cilën përfaqësuesi jonë ka të drejta të plota të nënshkruaj në emër dhe për llogarinë tonë duke mos patur asnjë pengesë për mungesë tagrash.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj me një afat të pacaktuar, me të drejtën e revokimit në cdo kohë I përfaqësuari deklaroi se: "Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeh legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje".
Prokura e posaçme, u lexua nga unë noterja qartë në prani të të përfaqësuarit, i cili e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e tij të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkruan atë rregullisht përpara meje noteres.
Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarit. Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarit nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të nenin 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**I PËRFAQËSUAR**

**Z. Altin PREMTI**
**Në cilësinë e ortkut të shoqërisë "SEED CONSULTING" sh.p.k**

Altin Premti

**Znj. Daniela NIKA**
**Në cilësinë e dhënëses së pëlqimit**

Daniela Nika

**NOTERE**
**STELA R. DEMNERI**

APLIKUAR
PULLA E TAKSES
STAMP OF TAX APPLIED

Nr. 5

**Vendim i Asamblesë së Përgjithshme**
**"Zurich Investment Group" Sh.p.k**

Sot, më datë **27/09/2023**, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë **"Zurich Investment Group" Sh.p.k**, me adresë në: **Rruga e "Kosovarëve", Pall. Dolcka, Ap 1/2, "Njësia Administrative Nr.5, 1019 Tiranë, "**, mbajti mbledhjen e përbërë nga

**-Z. Alban Efthimi**, i biri i Romeo-s, lindur më datë 13.10.1970 në Tiranë, i identifikuar me nr. personal H01013093A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, ortak i vetem, zotërues i kuotës së vetme, e cila përbën edhe **100%** të kapitalit të shoqërisë.

**ME REND DITE:**

1. Te miratohet shitja 100% e kuotës që shoqëria **"Zurich Investment Group" shpk** zotëron dhe ka në pronësi në shoqërinë **"SEED Consulting shpk"**, e cila përbën **12.5% e kapitalit** të kësaj shoqërie, në favor të blerësit **Z. Ylli Gjoni**.

*Pas diskutimit të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme,*

**V E N D O S I:**

1. Të pranojë shitjen e 100% të kuotës që shoqëria **"Zurich Investment Group" shpk** zotëron dhe ka në pronësi në shoqërinë **"SEED Consulting shpk"**, e cila përbën **12.5% e kapitalit** të kësaj shoqërie, në favor të blerësit **Z. Ylli Gjoni**.
2. Asambleja autorizon administratorin Z. Alban Efthimi për të përfaqësuar shoqërinë "Zurich Investment Group" shpk si palë shitëse në kontratën që do të bëjë të mundur transaksionin për shitjen e kësaj kuote.
3. Me përmbushjen e detyrimit të palëve, pra me nënshkrimin e kontratës për kalimin e kuotave dhe regjistrimin e saj në institucionet përkatëse, sipas kushteve të kontratës:
   **I** **Miratohet** shitja **100 %** (njëqind për qind) e kuotës që shoqëria "Zurich Investment Group" shpk zotëron dhe ka në pronësi në shoqërinë **"SEED Consulting" shpk**, e cila korrespondon me **12.5%** (dymbëdhjetë pikë pesë përqind) të kapitalit kësaj shoqërie, në favor të blerësit **Z. Ylli Gjoni.**
   **II Shoqëria "Zurich Investment Group" shpk largohet nga ortakëria e shoqërisë "SEED Consulting", e si pasojë, nuk ka më të drejta dhe detyrime, lidhur me këtë kuotë të shitur.**

**Zurich Investment Group Sh.p.k**
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

**Z. Alban Efthimi**

Alban Efthimi

Zurich Investment Group
Sh.p.k.
NUIS : M11825004M
TIRANË - ALBANIA

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX. 355 4 2420005
TEL 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20231003140728547 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 03.10.2023 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 14:07:28 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Fizik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-113-2108 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**ALTIN VELI PREMTI**
**OLSI ROMEO EFTHIMI**
**ANDI ROMEO EFTHIMI**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA

Olegi Hidri

Regjistri i Barrëve Sigurueses

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20231003140728547 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 03.10.2023 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 14:07:28 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Juridik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-113-2108 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**SEED CONSULTING SH.P.K.**
**ZURICH INVESTMENT GROUP SH.P.K.**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA

**SUBJEKTI KERKUES:**

Emertimi
ERMAL XHEVDET HAMZAJ P.F.

Megi Hidri

**TE DHENAT E PERDORUESIT:**

Emri dhe Mbiemri
MEGI HIDRI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M11825004M |
| 2. Data e Regjistrimit | 25/06/2021 |
| 3. Emri i Subjektit | Zurich Investment Group |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 18/06/2021 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 18/06/2021 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kosovareve, Pallati Dolçka" , Apartamenti 1/2 , Njesia Administrative nr. 5, Tirane |
| 8. Kapitali | 100,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen dhe marrjen pjese ne te gjitha aktivitetet qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, dhe ne veçanti Investime me pjesemarrje ne kuota.Ofrimi i sherbimit te konsulences, ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave, informatikes etj. Menaxhimi i qendrave tregtare, bareve dhe restoranteve. Importi-eksporti, shitja me shumice dhe pakice e pajisjeve elektrike, teknologjike, lende te para per industrine, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, pajisje zyrash kancelari, pjese kembimi, auto dhe makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike etj. Shitja, blerja, dhenia me qira e pasurive te paluajtshme; Transporti i malirave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit.cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar ne fuqi. |
| 10. Administratori/ët | Alban Efthimi |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 18/06/2021 | Deri: 18/06/2026 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | Blerjen e pasurive te paluajtshme te barabarte dhe nen 5 (pese) milion euro | |
| 12. Ortakët | AlbanEfthimi | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| **Të përfaqësuarit. (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)* | | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: Zurich Investment Group<br>E-Mail: lorenad@hotmail.com<br>Telefon: 0682050232 | |
| 15. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 03/10/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Date:2023/10/03 11:45:46
+02:00
M11825004M2023100311453
6612006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L41824014Q |
| 2. Data e Regjistrimit | 24/06/2014 |
| 3. Emri i Subjektit | SEED CONSULTING |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 18/06/2014 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 18/06/2014 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga "E Kosovarëve", Ndërtesa 35, H. 6, Ap. 2, Njësia Administrative Nr. 5, 1019 |
| 8. Kapitali | 83.756.523,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 5,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Realizimi i te gjitha fazave te pregatitjes se projektit duke filluar qe nga koncepti, fizibiliteti, projekt-ideja dhe projekti i zbatimit per te gjitha fushat e infrastruktures se transportit (rruge, ura, hekurudha, tunele, porte, aeroporte, etj.), mbikqyrja (supervizionimi) i tyre, si kolaudimi i veprave te infrastruktures se transportit, menaxhimi i kontratave dhe i zbatimit te projekteve te kontraktuara nga sipermarres ndertimi ne fushen e infrastruktures se transportit; realizimi i sherbimeve te konsulences ne fusha te ndryshme te infrastructures se transportit si negociim kontratash, prezantime propozimesh apo alternativash te ndryshme, vleresime tekniko-ekonomike, (cost-benefit analysis, due-diligence, etc.), vleresim skemash koncensionare, ekspertiza te ndryshme ne problematikat teknike si dhe negociim i mosmarreveshjeve kontraktuale ne ndertim, pregatitje Claim-esh, perfaqesim ne arbitrazhe etj; aktivizim ne promovimin, marketingun, lobbying-un dhe kontaktet me biznesin e ndertimit dhe organet e institucionet financuese; menaxhim i te gjithe procesit te pregatitjes se |

| | | |
|---|---|---|
| | dokumentacionit te nevojshem per pjesmarrjen ne prokurimet publike e private, vendase dhe te huaja ne fushen e infrastructures se transportit, organizimi i pjesmarrjes, ofertimi, negociimi dhe lidhja e kontrates | |
| 10. Administratori/ët | Alban Efthimi | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 12/12/2019 | Deri: 12/12/2024 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
